



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 20.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 19.05.2025, të parashtruar nga “Elektrika-Mont” Shpk nga Lipjani lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra”, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1 nxjerr këtë:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e “Elektrika-Mont” Shpk nga Lipjani dt. 19.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra”, me nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1.

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për " Item EL " SH.P.K. Rr.Burim Vitia Prishtinë.

Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 13.05.2025

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

“Elektrika-Mont” Shpk nga Lipjani, me datë 19.05.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra”, me nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1, ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues " Item EL " SH.P.K. Rr.Burim Vitia Prishtinë, **për shpërblim me kontratë** të datës 13.05.2025, dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

“Elektrika-Mont” Shpk nga Lipjani, me datë 19.05.2025 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra”, Autoriteti Kontraktues me datë: 20.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit tuaj të pare në lidhje për çmimet jo normalisht të uleta, AK ka marrë vendim duke u bazuar në vendimin e OSHP-se të datës 11.04.2025 me nr 2025/0069, 2025/0070 dhe 2025/0072 i cili thote: Paneli shqyrtues pas administrimit

dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik sipas nr, 2025/0069 dhe 2025/0070, aprovohet si pjeserishte e bazuar ndersa ankesa me nr 2025/0073, si bazuar për faktin se Paneli Shqyrtues ka analizuar oferten financiare të OE-së i cili është rekomanduar për dhenie të kontratës në çmimet e ofruar tek Lista e çmimeve konsiderohen si **çmime spekulative** artikujt tek pjesa I e paramases artikujt me nr rendor 28,38, Pjesa II e paramases artikulli nr 5,6,7,8,9,10,16,17,18,19,20 ,21,22,23, pjesa III e paramases artikujt 4,5,6,7,8,13,19,20,21,22,23, jane ofertuar çmimet prej 0.10 cent, pa i perfshier artikujt tjerë. Pra ne baze te ketij vendimi, çmimet e ofertes tuaj konsiderohen se jane çmime jo normalishte te uleta dhe spekulative. Ky pretendim eshte i pabazuar.

Sa i perket pretendimit tuaj te dyte per inxhinierin, edhe ketu ne baze te vendimit te OSHP-se te dates 11.04.2025 me nr 2025/0069, 2025/0070 dhe 2025/0072, ju jeni te papergjegjshem per arsye se ky inxhinier nuk eshte perfshire fare ne listen e stafit tuaj. Ndersa sa i perket pretendimit tuaj se te mbiemri i ketij inxhinieri ka ndodhur nje gabim teknik apo gjuhesore, ne baze te Legjislacionit te Prokurimit Publik ne fuqi dhe ne baze te vendimit te OSHP-se te lartcekur, nuk lejohet qe te kete mosperputhje ndermjet emrit dhe mbiemrit te personit te caktuar i cili eshte prezentuar ne liste dhe deshmive perkatese per kete person. Ky pretendin i juaj per kete pike eshte i pabazuar.

Sa i perket pretendimit tuaj te trete, perkatesishte listes se punetoreve te prezentuar nga ana e OE te rekomanduar per kontrate, ne lidhje me ate se OE i rekomanduar ne liste ka paraqitur nje person si menaxher dhe drejtor, ndersa te deshmite ka paraqitur vendimin per emerimin e menaxherit nje person tjetër, ky pretendin nuk qendron per arsye se personi i cili eshte paraqitur ne liste si menaxher ne baze te dokumentacionit te OE te rekomanduar per kontrate, behet fjale per menaxher dhe drejtor te kompanise, e jo si menaxher i ketij projekti.

Pra sic shifet lista ka treguar Hirearkin brenda OE, ndersa tek deshmite ka ngarkuar vendimin mbi caktimin e menaxherit te kerkuar sipas FTD-se.

LISTA E PUNTOREVE ITEM EL sh.p.k			
NR	EMRI	MBIEMRI	POSITA
1	ARMET	VITA	MANAXHER DHE DREJTOR - ELEKTRICIST
2	ASAZ	KELPENOI	INXHINIER ELEKTRIKES
3	ADENI	BARDEA	SHKURTER I ELEKTRIKES dhe Automatik
4	ASTRIT	VITA	ELEKTRICIST
5	ARDIT	VITA	PUNTOR
6	BALEMI	BARDEA	INSTALUES ELEKTRIK
7	BLENIM	VITA	ELEKTRICIST
8	YLLI	BARDEA	INSTALUES ELEKTRIK
9	RAMUSH	VITA	PUNTOR me Qendrese per Siguri ne Pate
10	VEYON	BARDEA	PUNTOR me Qendrese per Siguri ne Pate
11	ARMEND	VITA	PUNTOR me Qendrese per Siguri ne Pate
12	HAVIDHE	VITA	PEREMBAJTESE

Sa i perketë pretendimit tuaj të katërt edhe ky pretendim është i pabazuar për arsye se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij, përketasish të në listën e stafit i ka të prezentuar këta dy teknika të diplomuar të elektros tek lenda.

Shifë listën dhe dëshmitë të cilën e keni pranuar në qasjen të cilën e keni pasur në ofertat për këtë aktivitet të prokurimit.


Sa i perketë pretendimit tuaj të pestë, lidhur me inxhinierin e diplomuar të elektroteknikës drejtimi automatike dhe elektroteknike ku në kontratë, përketasish të në fund të saj ky inxhinier paraqitet si menaxher i projektit, edhe ky pretendim është i pabazuar për arsye se ky inxhinier veten e quan menaxher të projekteve dhe për këtë e ka potencuar sik shkruan në kontratë, ndërsa me vendim të ofertuesit i cili është rekomanduar për kontratë është caktuar menaxheri i projektit dhe i cili i plotëson kërkesat e AK-së, ndërsa sa i perketë asaj që në CV-në e tij ky inxhinier është prezentuar si inxhinier dhe menaxher i projekteve në emrin e një kompani tjetër, edhe kjo nuk qëndron për arsye se në këtë rast në CV ky inxhinier paraqet në emrin e kompanisë në të cilën punon ose ka punuar si dhe pozicionin në atë kompani. Po ashtu në bazë të Legjislacionit të Prokurimit Publik në fuqi nuk është e ndaluar që dy kompani të ndryshme të ofertojnë në të njëjtin aktivitet të prokurimit me stafin e njëjtit, për arsye se në këtë rast vetëm një kompani shpërblehet me kontratë nga ana e AK-së.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Bekim Shaban

Drejtor i Prokurimit